




BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 18-24 MUAJSH **MUAJI MAJ**



PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

Kuriozitete për muajin MAJ



Çfarë duhet të dimë për muajin Maj?

- * Muaji Maj është muaji i buzëqeshjeve.
- * Muaji Maj është muaji i biçikletave.
- * Muaji Maj është muaji i fotografisë.
- * Muaji Maj është muaji i luleshtrydhes.
- * Në muajin Maj çelin luleboret, trëndafili dhe tulipani.



Muaji Maj- Tema: Format e argëtimit dhe lojërat

Grupi: 18-24 muajsh

- * **Java I:** Format e argëtimit
- * **Java II:** Lojërat me ngjyrat
- * **Java III:** Lojërat me numrat
- * **Java IV:** Programi për 1 Qershorin



Tema mujore: Format e argëtimit dhe lojërat




Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Format e argëtimit	Të njohim fëmijët me format e argëtimit. Disa elementë të rëndësishëm që ndikojnë pozitivisht në zhvillimin motor, emocional dhe social të tyre.	Java I
Lojërat me ngjyrat	Përsëritja e ngjyrave kryesore përmes punës së dorës dhe lojërave.	Java II
Lojërat me numrat	Përsëritja e numrave 1-5 dhe organizimi i aktiviteteve dhe lojërave me këta numra.	Java III
Programi për 1 Qershorin	Përgatitjet për festën e 1 Qershorit.	Java IV





Shënim:



- * Staf i edukator duhet ta realizojë sa më qartë shpjegimin dhe realizimin e aktiviteteve me qëllim asimilimin sa më thjeshtë të njohurive nga fëmijët.
- * Staf i edukator duhet të informojë prindërit mbi tematikën mujore/javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.

Tema mujore: Format e argëtimit dhe lojërat





Tema e javës: Format e argëtimit





Java I	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Sporti dhe rëndësia e tij 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve për sportet dhe rëndësinë e tyre për shëndetin p.sh :</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Sportet forcojnë trupin dhe muskujt. ✓ Sportet na ndihmojnë të mësojmë të luajmë në grup. <p>Aktivitete:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Loja e futbollit: Edukatorja mëson dhe ndihmon fëmijët të godasin topin me këmbë. Loja zhvillohet në oborr. 2. Loja e basketbollit: Edukatorët improvizojnë lojën e basketbollit në grup duke i nxitur fëmijët të hedhin topin për të bërë kosh. <p>Vjersha: “Topi im” Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin një top, ose një fëmijë duke luajtur, të përgatitur më parë nga edukatorja.</p>	<p>Mjete Didaktike: Topa, kosha, rrjeta, Fletë A4 të bardha, Lapsa me ngjyra, Libri “365 rrëfenja para gjumit”.</p> 
E Martë	Libri një mik i mirë i fëmijëve 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve për librat dhe rëndësinë e tyre. Edukatorja iu tregon fëmijëve librat në grupin e tyre duke i shfletuar së bashku, fëmijët tregojnë me gisht figurat dhe i emërtojnë ato etj.</p> <p>Loja: “Libri i përkimit të ngjyrave”. Vjersha: “Librat rradhë-rradhë”. Përralla: “Zonja Lepurushe”.</p>	<p>Mjete Didaktike Manuali i Vjershave Libri me përralla “365 rrëfenja para gjumit” f.73</p>



<p>E Mërkurë</p>	<p>Muzika dhe Kërcimi</p> 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja u tregon fëmijëve për muzikën dhe kërcimin:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ A pëlqeni të dëgjoni muzikë, po të kërceni? ✓ Cfarë këngësh/kërcimesh ju pëlqejnë? ✓ A ju këndon mami/babi në shtëpi? <p>Ato i tregojnë fëmijëve veglat muzikore (lodra ose figura).</p> <p>Këngë lëvizore: “Nëse ti që je i lumtur”, “A ram sam sam”.</p> <p>Aktivitet: “<i>Improvizojmë një shfaqje muzikore</i>” fëmijë të cilët këndojnë, luajnë veglave muzikore, fëmijë që kërcëjnë.</p>	<p>Manuali i Vjershave Vegla muzikore prej lodre (dauille, kitarë, piano, mikrofon etj) Libri “365 rrëfenja para gjumit”.</p> 
<p>E Enjte</p>	<p>Fëmijët dhe piktura</p> 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatoria iu flet fëmijëve për lapsat, bojërat, ngjyrat me të cilat mund të vizatojmë dhe të krijojmë figura të ndryshme me to.</p> <p>Aktivitet: Të krijojmë nëpërmjet gishtave, duarve, kunjave, pirunjve, figura të ndryshme (tulipanë, lulebore, flutur etj) me ngjyra të shumëllojshme (sipas fotove).</p> <p>Këngë lëvizore: “Duart nga e majta, duart nga e djathta”.</p> <p>Lojë energjike: me shami, me top, me birila, me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja, etj. Lojërat të zhvillohen në oborr.</p>	<p>Mjete didaktike: Letra A4, bojwra me ngjyra, kunj veshwsh, pirunj plastik.</p> 

<p>E Prente</p>	<p>Mësojmë të vizatojmë një buzëqeshje</p> 	<p>Bisedë: edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve që muaji Maj është muaji i buzëqeshjeve. Ajo u tregon sesi ndihemi ne kur buzëqeshim duke ftuar fëmijët të imitojnë me mimikë një buzëqeshje.</p> <p>Aktivitet: Fëmijët mësojnë të vizatojnë fytyrën e buzëqeshur. Pas vizatimit ata e ngjyrosin fytyrën me një ngjyrë sipas dëshirës.</p> <p>Vjersha: “Topi im”</p> <p>Këngë lëvizore: “Nëse ti je i lumtur”</p>	<p>Mjete didaktike: letra dhe lapsa me ngjyra.</p> 
------------------------	--	--	--

Tema mujore: Format e argëtimit
Tema e javës: Njohja me ngjyrat





Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p align="center">Ngjyra e kuqe</p> 	<p>Vjersha: “Qershia”.</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën e kuqe dhe se ku e gjejmë atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Në natyrë, tek bimët, lulet, pemët, ✓ Tek insektet/gjallesat, si p.sh: nusepashka, gaforrja ✓ Tek frutat dhe perimet: mollët, qershitë, luleshtrydhet, domatet,specet etj. <p>Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë objektet/veshjet me ngjyrë të kuqe që ndodhen përreth, në libra apo tablo.</p> <p>Punë dore: Krijimi i luleshtrydhes, qershisë ose mollës me plastelinë të kuqe. Edukatorët mund të përdorin ilustrimin e këtij materiali.</p> <p>Lojë energjike: me shami, me top, me rathë, etj.</p>	<p>Mjete Didaktike: karton , letra A4, lapsa, plastelinë e kuqe</p> 
E Martë	<p align="center">Ngjyra e gjelbër</p> 	<p>Vjersha: “Ngjyrat e ylberit”.</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën e gjelbër dhe ku e gjejmë atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Në natyrë, tek pemët, bari, gjethet, ✓ Tek kafshët: bretkosa, breshka etj, ✓ Tek frutat dhe perimet: dardha, molla, rrushi, speci, kastravec, brokoli. <p>Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë sendet me ngjyrë të gjelbër që ndodhen në çerdhe.</p> <p>Përralla: “Bretkosa e gjelbër”.</p> <p>Punë dore: Pasi kemi mbledhur gjethë në ngjyrë të gjelbër në oborr (në forma e madhësi të ndryshme), fëmijët krijojnë me ndihmën e edukatores forma kafshësh/insektesh/figura me to.</p> <p>Këngë lëvizore: Sipas dëshirës.</p>	<p>Mjete Didaktike: Gjethë të formave/ madhësive të ndryshme, letra A4, lapsa. Libri “365 rrëfenja para gjumit”. (f.74)</p> 




<p>E Mërkurë</p>	<p>Ngjyra blu</p> 	<p>Vjersha: “Peshku blu”.</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën blu dhe se ku e gjejmë atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Ngjyra e detit, disa peshqeve ✓ Ngjyra e qiellit. <p>Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë objektet/veshjet me ngjyrë blu që ndodhen përreth tyre ose në libra apo tablo.</p> <p>Punë dore: Fëmijët me ndihmën e edukatores improvizojnë detin me mjete të riciklueshme.</p> <p>Vjersha: “Tullumbace të kam xhan”</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> <p>Mjete didaktike: Qese plastike, peqsh në ngjyrë blu, katrona A4, gërshtë.</p> 
<p>E Enjte</p>	<p>Ngjyra e verdhë</p> <p>Krijojmë me punë dore luledielliin/bletën</p> 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrën e verdhë dhe se ku e gjejmë atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Në natyrë, tek lulet si: luledielli. ✓ Tek shpendët/insektet, si bleta, zogu i verdhë etj ✓ Tek frutat/perimet, si p.sh, pjepri, speci, kungulli, banania, limoni. <p>Edukatorja ndihmon fëmijët të identifikojnë sendet me ngjyrë të verdhë që ndodhen në çerdhe.</p> <p>Punë dore: Npërmjet letrave me ngjyra (të verdhë dhe të zezë) krijojmë bletën ose luledielliin. Edukatorët mund të përdorin ilustrimet në këtë material.</p> <p>Vjershë: “Bletëza punëtore”.</p> <p>Lojë energjike: <i>Përkimi i ngjyrave</i>. Ndarja e topave sipas ngjyrave në gotat përkatëse.</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> <p>Mjete Didaktike: lapsa me ngjyra, fletë të bardha A4. Topa dhe gota me ngjyra.</p> 

<p>E Prente</p>	<p>Përsëritje e ngjyrave (blu, e kuqe, e gjelbër, e verdhë)</p> 	<p>Vjersha: “Ngjyrat e ylberit”.</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu tregon fëmijëve për ngjyrat që mësuuan gjatë javës (blu, e kuqe, e verdhë, e gjelbër) dhe përsërit së bashku me fëmijët se ku i gjejmë ato: në natyrë, tek bimët, lulet/tek kafshët/tek frutat dhe perimet etj.</p> <p>Punë dore me plastelinë: Edukatorja ndihmon fëmijët të krijojnë ylberin me plastelinë.</p> <p>Lojë energjike: Edukatorët së bashku me fëmijët krijojnë një këpucë prej letre, të cilën fëmijët duhet ta veshin dhe të bëjnë ndarjen e topave me ngjyrë sipas udhëzimit të dhënë. (Fëmijët i kapin topat me këpucën e krijuar).</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete didaktike: plastelinë, fletë A4, topa me ngjyra, karton, gërshtë.</p> 
------------------------	---	--	--

Tema mujore: Format e argëtimit

Tema e javës: Lojërat me numrat.



Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<p>E Hënë</p>	<p>Përsërisim numrat 1-5</p> 	<p>Vjersha: “1, 2, 3”.</p> <p>Përsërisim numrat: Përsëritja e numrave 1-5. Edukatorja ndihmon fëmijët të përsërisin numrat 1-5 duke përdorur 5 shqisat e njeriut (1 hundë/gojë, 2 sy/veshë, 4 gjymtyrë: 2 këmbë/2 duar dhe 5 gishta).</p> <p>Aktivitet: Krijojmë me punë dore gjethe dhe nusepashke të vogla. Edukatorët ndihmojnë fëmijët të ngjisin nusepashket në gjethe sipas numrit që ka secila gjethe (ilustrimi me foto).</p> <p>Këngë lëvizore: “Një elefant po kolovitet”.</p> <p>Vjersha: “Më gëzon në Maj ti mua”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike</p> 
<p>E Martë</p>	<p>Krijimi i krimbit me numrat 1-3</p> 	<p>Vjersha: “Më gëzon në Maj ti mua”.</p> <p>Lojë energjike: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja, etj. Lojërat zhvillohen në oborr.</p> <p>Punë dore: Ngjitja e numrave ose pikturimi me gishta (sipas fotos) tek krimbi i formuar nga rrathët me numra 1-3 sipas renditjes në fletën e vizatuar. Pas renditjes, së bashku me edukatoren, fëmijët emërtojnë dhe ngjyrat.</p> <p>Përralla: “Tri fluturat”.</p>	<p>Mjete Didaktike: fletë me ngjyra, bojwra, gërshërë, ngjitëse, fletë A4, lapsa me ngjyra.</p>
<p>E Mërkurë</p>	<p>Krijimi i krimbit me numra 3-5</p> 	<p>Vjersha: “Më gëzon në Maj ti mua”.</p> <p>Këngë lëvizore: “5 Majmunët”</p> <p>Lojë energjike: me shami, me karrige, me birrila etj.</p> <p>Punë dore: Ngjitja e numrave 4-5 tek krimbi i formuar nga rrathët me numra.</p> <p>Përralla: E lirë</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Mjete Didaktike: fletë me ngjyra, bojwra, gërshërë, ngjitëse, fletë A4, lapsa me ngjyra.</p>




<p>E Enjte</p>	<p>Mësojmë të rradhisim</p> 	<p>Vjersha: “Këtu jam unë”.</p> <p>Aktivitet: Edukatorja ndihmon fëmijët të krijojnë akulllore apo lule sipas numrave nga 1-5 (duke përdorur ilustrimet në këtë material).</p> <p>Përrallë: “Brunoja, ariu bojëkafë”.</p> <p>Vjersha: “Numrat”.</p> <p>Këngë lëvizore: “Një elefant po kolovitet”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Libri “365 rrëfenja para gjumit”. (f.74)</p> 
<p>E Premte</p>	<p>Dita e edukatores</p> 	<p>Edukatores mendojnë vet për aktivitetet që do të organizojnë sot.</p> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>	



Tema mujore: Format e argëtimit

Tema e javës: Përgatisim vjersha e këngë për Festën e 1 Qershorit



Java IV	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Krijimi i kapeles</p> 	<p>Vjersha: “Topi im”.</p> <p>Këngë lëvizore: Sipas dëshirës.</p> <p>Bisedë: Edukatorja bisedon me fëmijët lidhur me festën e 1 Qershorit.</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Çfarë është Festa e 1 Qershorit, ✓ Çfarë bëjnë fëmijët gjatë festës së 1 Qershorit. <p>Iu tregon se do të bëhet një festë për fëmijët, iu tregon se ata aty do të recitojnë, luajnë dhe këndojnë.</p> <p>Vjersha: “1 Qershori”.</p> <p>Kënga “1 Qershori”.</p> <p>Punë dore: <i>Kapelet e 1 Qershorit.</i> Edukatorët me fletë kartoni bëjnë kapele sipas dëshirës duke jua treguar fëmijëve.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: fletë kartoni të bardha ose me ngjyra.</p> 

<p>E Martë</p>	<p>Ngjyrosja ose zbukurimi i kapeles</p> 	<p>Vjersha: “Më gëzon në Maj ti mua”.</p> <p>Lojë energjike: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja dhe lojë me shami. Lojërat zhvillohen në oborr.</p> <p>Vjersha: “1 Qershori”.</p> <p>Kënga “1 Qershori”.</p> <p>Punë dore: Edukatorët ngjyrosin ose ngjisin topa (materiale të tjera) me ngjyra tek kapelet e tyre duke i pyetur fëmijët për ngjyrat e topave apo zbukurimeve dhe cilat ngjyra ata pëlqejnë në kapelet e tyre (të krijuara një ditë më parë).</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: lapsa me ngjyra, fletë me ngjyra.</p> 
<p>E Mërkurë</p>	<p>Përgatitim vjersha e këngë për Festën e 1 Qershorit</p>	<p>Vjersha: “Dallëndyshja”.</p> <p>Përralla: “3 fluturat”. Paraqitje me video-projektor.</p> <p>Vjersha: “1 Qershori”.</p> <p>Kënga:“1 Qershori”.</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> 

E Enjte	Përgatisim kartolinat për Festën e 1 Qershorit 	Përralla: “3 fluturat”. Edukatorja vendos fëmijët më të vegjël ta shikojnë përrallën e improvizuar nga fëmijët në grupet e mëdha. Aktiviteti zhvillohet në oborr. Vjersha: “1 Qershori”. Kënga “1 Qershori”. Ngjyrosje/Punë dore: <i>Krijojmë kartolinat për 1 Qershorin.</i> Fëmijët ngjyrosin me ndihmën e edukatoreve lulet e pranverës si, luledielli, tulipanët, trëndafilat duke krijuar një kartolinë për shokun/shoqen e grupit.	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike 
E Premte	Përgatisim vjersha e këngë për Festën e 1 Qershorit	Vjersha: “Ngjyrat e ylberit”. Vjersha: “1 Qershori”. Kënga “1 Qershori”. Lojë e lirë.	Manuali i Vjershave Mjete Didaktike